



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 11.6.2015, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Shqipe Pantina, Zafir Berisha dhe Jelena Bontic.
Munguan: Kujtim Paçaku, dhe Pal Lekaj.

Në mbledhje morën pjesë, përfaqësuesit e OSBE-së, BIRN-it dhe KDI-së.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina, Mirjeta Heta dhe Flaka Zairi, praktikante në Komision, nga UNDP.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i planit të veprimit të grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2014;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Zenun Pajaziti, pyeti anëtarët e Komisionit se a pajtohen me rendin e ditës.

Anëtarët e Komisionit patën vërejtje në pikën e tretë të rendit të ditës.

Shqipe Pantina, tha se Raporti për shërbimin civil, është raport që identifikon sfidat, problemet dhe rekomandimet e Qeverisë për shërbimin civil. Raporti për shërbimin civil, që është hallka kryesore e administratës publike, është hartuar në mënyrën më të dobët, për më tepër, me arsyen që jemi në procesin e reformimit të shërbimit civil.

Zenun Pajaziti, tha se raporti përfshin punën e shërbimit civil, ndërsa sa i përket formës, është i hartuar konform formatit, ndërsa për reformën e shërbimit civil kemi disa ligje të tjera që lidhen drejtpërdrejt me reformën e administratës publike.

Sadri Ferati, propozoi që raporti të shtyhet për mbledhjen e radhës. Në këtë kontekst, ai propozoi një punëtori me MAP-in për reformën në shërbimin civil.

Zafir Berisha, meqë kishte disa pyetje lidhur me raportin, ai pyeti se kush e prezanton raportin për sqarime para Komisionit dhe propozoi që të ftohen përfaqësuesit e Qeverisë për të prezantuar raportin.

Xhevahire Izmaku, propozoi që të ftohen për ta prezantuar raportin, përveç përfaqësuesve të MAP-së, edhe përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit, ndërsa sa i përket cilësisë së raportit, ka hapësirë për të diskutuar për kualitetin e raportit.

Zenun Pajaziti, miratoi propozimet e anëtarëve të Komisionit, që raporti të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

2. Miratimi i planit të veprimit të grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve

Zenun Pajaziti, i njoftoi anëtarët e Komisionit se kryesueset e grupeve punuese për monitorimin e ligjeve, znj. Shqipe Pantina dhe znj. Xhevahire Izmaku, kanë hartuar planet e punës për monitorimin e ligjeve dhe kërkoi nga ato që t'i prezantojnë para Komisionit.

Shqipe Pantina, njoftoi Komisionin për draft- planin e punës për monitorimin e Ligjit për OJQ-të, i cili plan në përmbajtje përmbante institucionet të cilat do të vizitohen, si dhe OJQ-të mikrofinanciare. Ajo propozoi se nëse dikush nga anëtarët e Komisionit ka ndonjë rekomandim, të deklarohen, në mënyrë që të inkorporohen në raport, para fillimit të punës së grupit punues.

Zenun Pajaziti, propozoi që së paku një ditë pune e javës, të caktohet për aktivitetet e grupit punues për monitorimin e ligjeve. Ai pyeti znj. Pantina se a janë përzgjedhur se cilat OJQ do të monitorohen.

Shqipe Pantina, janë dy grupe të OJQ-ve për monitorim: shoqatat dhe fondacionet. Pra, ato që janë me anëtarësi dhe ato sipas kauzës. Për fillim, grupi punues do të marrë listën e OJQ-ve nga Departamenti për Regjistrimin Civil për OJQ, e pastaj do të përzgjedhen se cilat OJQ do të monitorohen.

Xhevahire Izmaku, e njoftoi Komisionin për planin e punës për monitorimin e Ligjit për administratën shtetërore. Ajo tha se është një punë voluminoze, për arsye se do të monitorohen institucionet e administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal, ZKM-ja, Qeveria dhe IKAP-i. Është më se e domosdoshme mbajtja e një debati për administratën shtetërore, si dhe një vizitë në administratën e ndonjë konsullate. Gjithashtu, ajo tha se i mirëpret propozimet shitesë për plotësimin e planit të punës nga anëtarët e grupit punues.

Sadri Ferati, në cilësinë e kryesuesit të grupit punues për monitorimin e Ligjit për kufijtë administrativ të komunave, tha se grupi punues ka pasur një vizitë në Komunën e Junikut. Në javën e ardhshme, propozoi që të caktohet një vizitë në Komunën e Gjilanit dhe të Novobërdës, ku dhe grupi punues përfundon monitorimin e ligjit. Ai propozoi që pasi të hartohet raporti për monitorimin e ligjit, të shqyrtohet nga Komisioni nëse nevojitet monitorim i mëtutjeshëm, grupi punues mund të vazhdojë me monitorim.

Xhevahire Izmaku, propozoi që të vizitohet edhe Komuna e Dragashit për monitorim të Ligjit për administratën shtetërore.

Konstatim: Komisioni miratoi propozimet e sipërsëhënuara.

3. Të ndryshme

Pasi për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime, mbledhja përfundoi.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetari i Komisionit,
Zenun Pajaziti**
